



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 39, Datë 10.02.2025

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SH.P.K. PËR
SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT NR. 263, DATË 02.12.2024**

Në mbështetje të, nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.02.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 65/1 prot., datë 05.02.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të bordit nr. 263, datë 02.12.2024”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 06.06.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 06.06.2023.
- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 2317 prot., datë 30.10.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj si dhe ne vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2317/2 prot., datë 08.11.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 263, datë 02.12.2024 u vendos dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. dhe ortaku i vetëm që kontrollon interesat e saj bëhet Znj. Freda Doçi.
- Me shkresën nr. 65 prot., datë 10.01.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 263, datë 02.12.2024, duke sqaruar se kuotat nuk janë transferuar te Znj. Freda Doçi për arsye të prishjes së marrëveshjes së shit-blerjes mes palëve.
- Nga sa konstatuar nga ana jonë në ekstraktin historik të shoqërisë nuk është bërë asnjë kalim/ndryshim, si e tillë korrespondon edhe me sa thënë dhe kërkuar nga shoqëria se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në vijim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 263/2024.

- Për sa kërkuar nga subjekti si dhe në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton ndër të tjera se një akt administrativ mund të anulohet ose shfuqizohet nga organi publik që e ka nxjerrë, nga organi epror i tij, ose nga një organ tjetër kompetent, sipas ligjit, vlerësohet të shfuqizohet vendimi nr. 263, datë 02.12.2024 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. Si e tillë, kuotat e shoqërisë do të vijojnë të mbahen nga ortakët e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. sikurse rezultonin para vendimit të bordit të ERE nr. 263, datë 02.12.2024 mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë vendimin e ERE nr. 263, datë 02.12.2024 “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE
Erjola SADUSHI**